R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË

PROGRAMI I DISIPLINËS

METODOLOGJITË E MËSIMDHËNIES

DREJTIMI: MËSUESI

Pedagogu:	*Prof.Dr. Bardhyl Musai*
Ngarkesa:	*8 ETCS (4 leksione dhe 2 seminar në javë)*
Frekuenca:	*60 leksione, 30 seminare*
Lloji i lëndës:	*E detyrueshme*
Programi i studimit:	*Master Mësuesi*
Viti/Semestri:	*I/I*

Lënda ka karakter modular dhe është e përbërë nga modulet: Metodologji e mësimdhënies dhe Mendimi kritik, Psikologji e Zbatuar në Mësimdhënie dhe Zhvillimi i Kurrikulës.

MODULET: METODAT E MËSIMDHËNIES DHE MENDIMI KRITIK

Shkurtesë: *Metodologji e mësimdhënies* është shqyrtimi dhe studimi i praktikave më të përdorshme dhe të përshtatshme sot në procesin e mësimdhënies në të gjitha nivelet dhe llojet e shkollimit, i klasifikimit të karakteristikave të çdo modeli, natyrës, evoluimit dhe zhvillimit të secilit prej tyre, shqyrtimin e aspekteve të metodave të mësimdhënies, të menduarit kritik përmes metodave të të nxënit aktiv, aspekteve psikologjike të zbatuara në mësimdhënie dhe aftësimi i studentëve më pas për të zhvilluar kurrikulën dhe të planifikojnë mësimin.

Moduli: Metodat e mësimit

Metodat e mësimit trajtohen me të githë elementet e tyre, duke filluar nga objektivat mësimorë, planifikimi i mësimor, zhvillimi i metodave ndërvepruese që nxitin të nxënët aktiv dhe deri te vlerësimi i nxënësve

Moduli: Të menduarit kritik

Qëllimi i këtij moduli është të ofrohen shprehitë me kryesore që u mundësojnë studentëve, mësues të ardhshëm, të japin mësim për zhvillimin e gjithanshëm intelektual të nxënësve për shprehitë e të menduarit kritik.

Temat e mësimit*:*

1. Mësuesi, mësimdhënia dhe mjeshtëritë e saj.

Qëllimet dhe objektivat

2. Mësimdhënia për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë.

Procesi dhe mjeshtëritë e të pyeturit

3. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim

4. Vlerësimi i përparimit të nxënësve

5. Procesi i të lexuarit dhe të nxënit ndërvepruese.
6. Metoda për mësimdhënien dhe të nxënët (1-5)
7. Metoda për mësimdhënien dhe të nxënët (6-10)
8. Metoda për mësimdhënien dhe të nxënët (11-15)
9. Metoda për mësimdhënien dhe të nxënët (16-20) `
10. Metoda për mësimdhënien dhe të nxënët (21-25)
11. Të menduarit shkollor me gjuhë shkollore. Shprehitë e mësuesve për zhvillimin e të menduarit, gjuhës dhe përmbajtjes
12. Shprehitë e të menduarit:
Analiza,
Krahasimi,
Kategorizimi dhe klasifikimi
13. Shprehitë e të menduarit:
Identifikimi i shkakut dhe pasojës
Zgjidhja e problemeve
Argumentimi bindës
14. Shprehitë e të menduarit:
Vënia e vetes në pozitën e tjetrit
Sinteza
Interpretimi
15. Shprehitë e të menduarit:
Vlerësimi
Komunikimi
Zbatimi

Forma e kontrollit dhe vlerësimi

Pjesëmarrje në leksione interaktive	*10%*
Aktivizim dhe pjesëmarrje në seminare e në veprimtari praktike	*10%*
Detyrat e njëpasnjëshme gjithësemestrale	*20%*
Detyra e kursit	*10 %*
Testi përfundmitar	*50%*
Gjithsej	*100%*

Shënim: *Vlerësimi i të dyja moduleve zë 50 % të vlerësimit përfunndimtar në këtë lëndë*

Literatura e detyrueshme

Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënie*s, Tiranë: Pegi
Vaughn,L. & McDonald,C. (2010). Fuqia e të menduarit kritik. Qendra për Arsim Demokratik
Musai, B. përg (2005). *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues - Metoda për zhvillimin e të menduarit kritik.* Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik
Zwiers, J. (2005). *Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6-12*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik

Literaturë e rekomanduar

Musai, B. përg. (2009). *Si të shkruajmë objektivat mësimorë për mësimdhënien dhe vlerësimin.*Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik

Musai, B. et.al (2008). *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues-modele mësimore në lëndë të ndryshme*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik

Crawford, A., Saul W., Mathews, R. S., & Makinster, J. (2005). *Strategji të mësimdhënies dhe të nxënit për klasat mendimtare.* Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik

MODULI: PSIKOLOGJI E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE

Shkurtesë: Nëpërmjet këtij moduli, studentët marrin njohuri të zgjeruara për mënyrat sesi organizohet dhe menaxhohet klasa, në të cilën përcillet informacioni shkencor dhe ndërtohen e zhvillohen format e komunikimit.

Mjedisi i të nxënit, stili i të nxënit , shprehitë sociale , sjelljet agresive dhe vlerësimi, nderhyrja tek keto sjellje zënë një vend shumë të rëndësishëm në synimet dhe objektivat mësimore të këtij kursi.

Gjatë këtij kursi studenti nuk do të mjaftohet vetëm me marrjen e njohurive teorike, por do t'i mëshohet fort edhe trajtesave të problemeve socilale që hasen. Seminaret, esetë, detyrat e kursit, ilustrimet e ndryshme do të ndihmojnë fuqishëm në këtë drejtim.

Temat e leksioneve:

1. Objekti dhe historia e psikologjisë së zbatuar në mësimdhënie. Organizimi dhe menaxhimi i klasës
2.Përforcuesit, vlerësimi, shpërblimet dhe motivimi
3.Aktivitetet e menaxhimit të klasës për të krijuar një mjedis pozitiv për të mësuar. Si tu mësojmë nxënësve shprehitë sociale
4.Strategjitë e mësimdhënies
5.Përfshirja e prindërve në edukim
6.Parandalimi i sjelljeve të papërshtatshme
7.Vlerësimi i sjelljes dhe ndërhyrjet lidhur me të në klasë
8. Sjelljet agresive dhe llojet e tyre

Forma e kontrollit dhe vlerësimi

Vlerësimi përfundimtar i studentit për këtë lëndë do të bazohet në shumën e pikëve të grumbulluara në veprimtaritë mësimore, që në mënyrë të përmbledhur janë:

Pjesëmarrja dhe aktivizimi në mësim	*10 pikë*
Punimi përfundimtar	*40 pikë*
Provim	*50 pikë*
Gjithsej:	*100 pikë*

Shënim: *Vlerësimi në këtë modul zë 25 % të vlerësimit përfundimtar në këtë lëndë*

MODULI: ZHVILLIMI I KURRIKULËS

Shkurtesë: Programi i kësaj lënde, synon t'u japë studentëve një vështrim të përgjithshëm të bazave, parimeve dhe problemeve të kurrikulës: *bazat e kurrikulës:* filozofike, historike, psikologjike, sociale dhe teorike, që ndikojnë në këtë të fundit; *parimet:* që kanë të bëjnë me mjetet dhe metodat e përdorura për kurrikulën, për zhvillimin, hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës, qëllimet, synimet dhe objektivat e kurrikulës; *problemet:* merren me teoritë dhe problemet e sotme, si dhe prirjet dhe drejtimet në të ardhmen.

Gjithashtu,ky program synon ti njohë studentët me kontekstin shqiptar të zhvillimit të kurrikulës, me kornizën kurrikulare, planet mësimore, programet mësimore, tekstet shkollore, vlerësimin e kurrikulës, zhvillimin profesional të mësuesit, mbrojtjen e fëmijëve, si dhe planifikimin e orës së mësimit.

Temat e leksioneve:

1.Fusha e kurrikulës, metodat e kurrikulës
2.Parimet e ndërtimit të kurrikulës. Metodat teknike e shkencore dhe joteknike joshkencore te kurrikulës
3.Hartimi i kurikulës. Modelet përfaqësuese te kurrikulës
4.Qëllimi, synimi dhe objektivat . Nivelet klasifikuese të objektivave arsimorë Planet mësimore, programet mësimore. Tekstet shkollore. Procesi i hartimit të tyre.
5.Kurrikula dhe shoqëria
6.Përmirësimi i kurrikulës
7.Zbatimi i kurrikulës
8.Vlerësimi i kurrikulës

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

Vlerësimi përfundimtar i studentit për këtë lëndë do të bazohet në shumën e pikëve të grumbulluara në këto veprimtari mësimore:

Pjesëmarrja në mësim	*10 pikë*
Detyrë kursi individuale	*15 pikë*
Detyrë kursi në grup	*15 Pikë*
Provim i ndërmjetëm midis javës së 6-8	*20 Pikë*
Provimi përfundimtar	*40 pikë*
Gjithsej:	100 pikë

Shënim: *Vlerësimi në këtë modul zë 25 % të vlerësimit përfundimtar në këtë lëndë*

Literatura bazë

Kurrikula bazat, parimet dhe problemet. Autorë: Allan C. Orstein, Francis P. Hunkins.
Manuali i Mbrojtjes së Fëmijëve për shkolla, Botim i "Terre des Hommes".
Mbrojtja e Fëmijëve – Udhëzuesi Praktik për profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Botim i "Terre des Hommes".

Literatura ndihmëse

Making the curriculum work. Botim i "Centre for educational research and innovation".
www.mash.gov.al ; www.izha.edu.al

Shënim: Nota përfundimtare në këtë lëndë del si rezulat i mbledhjes së pikëve të marra në të gjitha modulet. Pikët konvertohen në nota sipas skemës së miratuar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë.

Miratoi

Përgjegjësi i Departamentit

Prof.Dr. Romeo HANXHARI

Tiranë, 2016